



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.71/2016

Prishtinë, më 6.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Rrustem Berisha dhe Enver Hoti, anëtarë, si dhe Visar Ymeri, deputet.

Munguan: Glauk Konjufca, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

I ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Dukagjin Shala – MZHE, Alban Gollaku – MZHE, Vllaznim Krasniqi – MZHE, Fjolla Uka – KDI, Ahmet Tmava – TREPÇA, Vlora Nushi – SRSG/OPA UNMIK, Rahman Ramaj – BIRN, Blerta Bejtullahu – EUSK/EU Office, Kaltrina Zymberi – Ekonomia Online dhe Faton Salihu – RTK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. L-120 për Trepçën;
3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. L-120 për Trepçën

Kryetari i Komisionit, z. Muhamet Mustafa, ia jep fjalën ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Blerand Stavileci, që ta prezantojë Projektligjin nr. L-120 për Trepçën.

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, theksoi se vitin e kaluar kemi diskutuar për dy ligje për evitimin e likuidimit të Trepçës. Atëherë planifikuam që të bëhet studimi i fizibilitetit dhe projektligji për Trepçën. Më 16 mars u formua grupi punues për hartimin e projektligjit në përbërje edhe me ekspertë ligjorë. Ky projektligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së aseteve dhe avancimin e kapitalit tekniko -teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik. Dispozitat e këtij projektligji, përcaktojnë transformimin e disa njësive biznesore të ndërmarrjes shoqërore Trepça, në Shoqëri Aksionare, me ç' rast, Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë pronar i 80 % të aksioneve, ndërsa punëtorë pronar të 20% të aksioneve. Po ashtu, ky Projektligj trajton edhe: resurset minerale, bartjen e pasurisë, të drejtave dhe burimeve njerëzore, statutin, regjistrimin dhe qeverisjen e shoqërisë aksionare, mundësinë e formimit edhe të njësive të tjera, mundësinë e pjesëmarrjes së sektorit privat, çështjet sociale dhe raportin me komunitetin, pretendimet e kreditorëve, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e materies që ky Projektligj do të rregullojë, ju rekomandoj aprovimin e tij, potencoi në fund z. Stavileci.

Kryetari theksoi se ky projektligj është i rëndësishëm, pasi krijon parakushtet për të vënë në efikasitet pasuritë natyrore të Kosovës. Ky projektligj edhe pse në rrethana dhe kushte të punës të vështirësuar ia ka arritur që në përgjithësi të bëjë zgjidhje të problemit. Për ne, është me rëndësi që Trepça të jetë si simbol i yni, por edhe me rëndësi është që Trepça të fillojë të prodhojë efekte në rritjen ekonomike dhe në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës. Njofton për organizimin e një dëgjimi publik për të hënë me ekspertë, ku do të diskutohet projektligji për Trepçën, e më pas grupi punues do të formulojë amendamentet dhe sipas procedurave të dërgohen në Kuvend. Rreth pjesëmarrjes së punëtorëve në 20% të aksioneve në pronësi të tyre mendoj se ligji ka shkuar në mënyrë konsekuente me një përqindje që iu është siguruar punëtorëve edhe në ndërmarrjet tjera shoqërore dhe ky është marrë si kriter pasi është standard në Kosovë. Rëndësia e pjesëmarrjes së punëtorëve në aksionet e Trepçës është motivim i tyre për punë dhe rrit transparencën në organet qeverisëse të Trepçës.

Besim Beqaj theksoi se ky Projektligj është prej projektligjeve më të rëndësishme që Qeveria e ka proceduar në Kuvend, e cila për kundër shume sfidave ka sjellë një ligj i cili adreson çështjet thelbësore që kanë të bëjnë me pasurinë dhe perspektiven e shtetit të Kosovës, besoj ky është një nga konstatimet themelore që në duhet t'i kemi për ligjin në fjalë. Ky ligj është hapi i pari i cili e definon kornizën zhvillimore të Trepçës dhe i cili ia heq nga barra disa obligime dhe disa asete të cilat realisht janë jo funksionale ku një pjesë e tyre do të mbesin nën menaxhim të AKP-së, respektivisht do t'i nënshtrohen procesit të privatizimit ose likuidimit sepse janë jo

esenciale. Unë besoj se Neni 5 i këtij Projektligji është prej neneve më substanciale sa i përket qeverisjes korporatave, sepse kemi të bëjmë fillimisht me tri njësi dhe pastaj potencialin që duhet ta zhvillojë Trepça në aspektin ekonomik dhe përpunimeve të metaleve të cilat duhet të ndodhin në vendin tonë, ka hapësirë që të precizohen gjërat edhe më shumë, por mbetet një ligj shumë i rëndësishëm. Efekt jashtëzakonisht i rëndësishëm është edhe trajtimi i punëtoreve, sepse përfshin të gjithë punëtorët pa dallim etnie dhe pa asnjë lloj dallimi tjetër. 20 përqindëshi i cili do të shkojë në pronësi të aksioneve i dedikohet punëtoreve të cilët kanë dhënë shumë mund dhe e kanë mbrojtur Trepçën në kohët më të vështira, në kohën kur ka pasur shumë paqartësi, keq menaxhim, menaxhim tendencioz për të shkatërruar pasurinë e Trepçës, realisht janë ata punëtorë të cilët kanë sakrifikuar veten e tyre dhe kjo është një mirënjohje për punën e tyre të gjatë. Sa i përket rentës minerare besoj se po tregon që shoqëria jonë ngadalë po shkon drejt shoqërive me përgjegjësi sociale. Përgjegjësitë sociale janë kërkesë e kohës, nuk shihet zhvillimi vetëm si çështje elementare dhe profitabilitet në kuptimin monetar, por duhet të shihet edhe si përfitim i drejtpërdrejtë i komunitetit, sepse hapet rruga edhe për investimet private, të cilat duhet të jenë komplet të harmonizuara me teknologjitë më të avancuara në kuptimin e ruajtjes së ambientit. Pra, kemi të bëjmë me një ligj i cili është i harmonizuar në kuptimin kushtetues dhe strategjik të interesit të shtetit dhe legjislativ duke e përfshirë edhe interesin e ndërmarrjes dhe komunitetit, por që në kuptimin operativ ndoshta ka hapësirë ligji të përmirësohet sa i përket bordeve menaxhuese dhe mbikëqyrëse, duhet të jemi shumë më konciz, shumë më precizë. Një çështje e pa trajtuar është pasuria e Trepçës jashtë Kosovës, qoftë në republikat e ish- Jugosllavisë, qoftë në vendet e tjera, edhe pse ky është projektligj kornizë i cili hap rrugën e shumë akteve të tjera ligjore, të cilat pastaj do ta definojnë shumë më mirë funksionimin e Trepçës.

Rafi Qela theksoi se pas shumë përpjekjeve, më në fund, para Kuvendit erdhi Projektligji për Trepçën. Projektligji i cili hap rrugë për zhvillimin e mëtutjeshëm të Trepçës. Ashtu siç e dimë të gjithë që më shumë se 26 vjet Trepça ka qenë në agoni, jo për shkak që nuk ka pasur potencial, por për shkakun që ka qenë e mbërthyer si pasojë e pengesave të shumta politike e jashtë politike. Tani me këtë projektligj hiqen ato pengesa, shkëputet nga varësia sidomos e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me çështjet e lidhura me AKP-në. Kjo varësi e pengonte vazhdimisht zhvillimin e vet sepse nuk kishte mundësi të bënte asnjë hap serioz drejt investimeve të reja. Ky projektligj në përgjithësi i plotëson nevojat themelore që Trepçës t'i hapet rrugë për zhvillim, por kjo nuk do të thotë se do të jetë shkop magjik për Trepçën, por ky ligj vetëm hap rrugë nëse të gjitha institucionet përkatëse me përgjegjësi e përkrahin zhvillimin e Trepçës dhe e çojnë në drejtimin e duhur. Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Menaxhues do të duhej që në përbërje të këtë njerëz të cilët janë kompetentë, të cilët do të duhej të dinë ta orientojnë zhvillimin e Trepçës dhe me të t'ia japin edhe një shtytje zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ne duhet ta përkrahim unanimisht këtë projektligj për arsye se rrugë tjetër në rrethanat aktuale unë nuk shoh, kam besim se Trepça do të bëhet njëra prej shtyllave për zhvillimin e Kosovës.

Sasha Milosavljeviq tha se dëshiroj që ta paraqes para jush qëndrimin e Listës Serbe. Ne do të jemi kundër miratimit në parim të këtij projektligji dhe përderisa nuk do t'i harmonizojmë qëndrimet e punëtoreve të Trepçës të cilët i përkasin komunitetit serb. Ne do të jemi kundër këtij ligji edhe në leximin e dytë. Ne mendojmë se punëtorët e Trepçës janë përjashtuar nga vendimmarrja për e fatin e Trepçës, nuk janë marrë parasysh qëndrimet tona dhe përfaqësuesve

tonë në Qeverinë e Kosovës, thjesht përfaqësuesit tonë nuk kanë marrë pjesë gjatë hartimit të këtij ligji. Mendojmë se një ligj i rëndësishëm kaq të madhe, siç është ky ligj, shumë shpejt është futur në rend të ditës, pasi ky ligj është kaq i rëndësishëm është dashur më shumë kohë për të punuar në të dhe nuk ka pasur kohë për t'u harmonizuar të gjitha qëndrimet e të gjithë përfaqësuesve që janë në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës dhe për të pasur një konsensus dhe një ligj të pranueshëm edhe për komunitetin serb, në atë rast do të ishim edhe ne për të, në parim jemi kundër, gjithashtu ne në parim do të jemi kundër edhe në Kuvend.

Rrustem Berisha theksoi se ne kemi marrë Projektligjin dhe deri në orët e vona e kemi diskutuar nen për nen. Në parim e përkrahim këtë projektligj por kemi edhe vërejtjet tona të cilat në mes të leximit të parë dhe të dytë do t'i prezantojmë, por kryesisht vërejtjet tona kanë të bëjnë me atë se çfarë shoqërie do të jetë Trepça. Rreth përqindjes së aksioneve ne mendojmë se duhet të jetë 75% në pronësi të Qeverisë së Kosovës dhe 25% në pronësi të punëtorëve dhe në këtë përqindje të përfshihen punëtorët që kanë punuar që nga viti 1989 e këndej edhe nëse dikush nga ta nuk është në këtë jetë të përfitojnë familjet e tyre. Edhe pse është ligj i vonuar, por në parim e përkrahim.

Sala Berisha – Shala tha se pavarësisht diskutimeve të mëparshme rreth asaj se është vonuar ose është shpejtuar ky ligj, e rëndësishme është se ne, si Komision Parlamentar, po diskutojmë rreth njërit prej ligjeve më të rëndësishme që është në fushëveprimin e Komisionit, por edhe të sektorit minerarë dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës. E para që dua ta diskutoj është se me këtë ligj bëhet edhe ç' mitizimi i Trepçës. Unë dua ta përkujtoj një kohë kur ka qenë në fuqi rregullorja e UNMIK-ut 2005/48, kam qenë pjesë e Komisionit dhe vërtet Trepça ka pasur rrezik potencial që të shkojë në likuidim. Mobilizimi i të gjithë deputetëve pa ngjyrimë politike dhe etnike dhe kemi organizuar debat në Kuvend, nga i cili debat ka dalë një rezolutë e cila për hirë të tjetër ka pasur efektin e tij pozitiv sepse e ka shpëtuar Trepçën nga likuidimi. Trepça nuk është e panjohur për shumicën tonë që jemi prezent këtu, por as për të tjerët, jemi shumë të familjarizuar nga aspekti i pozitive të ndryshme. Mendoj se ky projektligj nuk është as i përshpejtuar e as i ngutur, është ligji më i mirë i mundshëm që na ka ardhur në këtë situatë. Çështjet që nuk prekin esencën e ligjit, por që janë periferike mund t'i evitojmë gjatë amendamentimit, mbi të gjitha ky ligj definon kornizën zhvillimore jo vetëm të Trepçës, por të tërë sektorit minerar. Është shumë e rëndësishme se me këtë ligj rregullohet infrastruktura ligjore që synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime pasi që Kosova ka shumë nevojë për investime, e sidomos për ato të jashtme, rritjen e vlerës së aseteve, avancimin e kapitalit tekniko-teknologjik. Neni 2 është shumë esencial, njësitë biznesore të Trepçës që janë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Miniera dhe Minerale. Neni 5 i cili po ashtu është në harmoni të plotë me Kushtetutën dhe Ligjin për Miniera dhe Minerale. Kjo duhet të jetë njëra prej arsyeve që ne mos të humbim shumë kohë por ta zëmë hapin që t'i japim një kahe pozitive zhvillimit të Trepçës.

Visar Ymeri theksoi se këtu është përmendur edhe nga ministri edhe ka qenë një diskutim i gjatë natyrisht për Trepçën edhe për hapat që duhet të ndërmeren karshi këtij ligji për Trepçën dhe vendimeve për të. Mendoj se në këtë rast janë përzier hapat që të diskutojmë ligjin para se ta kemi parë strategjinë dhe para se me pasur një studim fizibiliteti për Trepçën. Tërë kjo kohë që është kaluar nga kur kemi diskutuar herën e fundit për këtë ligj, prej janarit të vitit 2015 deri më sot, Qeveria është arsyetuar me studimin e fizibilitetit dhe vetëdije më të madhe strategjike

se ngaa po duam të shkojmë për Trepçën! Përpilimin e një strategjie për të dhe pastaj ta nxjerrim ligjin. Në kuadër të kësaj tani vijm prapë në një moment, pas një viti e sa, ku jemi në të njëjtën gjendje, ku nuk kemi studim fizibiliteti, as strategji dhe po e diskutojmë ligjin, ku i bie se faktikisht jemi në një pikë ku të paktën formalisht nuk e dijmë se çfarë të bëjmë me Trepçën. Ligji në një farë forme është i përpiluar në atë formë që lë mundësi të shumëta të hapura, mirëpo, çfarë përmbledhet me këtë ligj mundësitë e hapura, metodologjit, privatizimi i pjesëshem i Trepçës të asaj që po e shëndrrojmë me këtë ligj në ndërmarrje publike siç quhet në shoqëri aksionare, pra të gjitha ato propozime që janë aty për të ardhmen e Trepçës, forma të ndryshme të privatizimit të saj ose të njësive të veçanta që lejohen në të. Mendoj që kjo është e gabuar në dy raste, mendoj që nuk shihet fare dhe nuk shpenzohet fare kohë dhe të mendohet se si do të shfrytëzohet Trepça në pronësi publike gjë që ishte rruga dhe mbet rruga e vetme për Trepçën dhe në anën tjetër është e gabuar se me këto vendime që po shihet në ligj pak a shumë Kuvendi përjashtohet. Pra, çfarë do vendimi për të ardhmen e Trepçës pas miratimit të këtij ligji do të bëhet në nivel të bordit të Trepës e natyrisht se Qeveria është 80% është pronare e aksioneve, natyrisht edhe me vendim të Qeverisë. Mirëpo Kuvendi nuk pytet, dhe mendoj që kjo është e pa pranueshme. Mendoj që Kuvendi duhet t'i jep vendimet e veta siç i ka këto të drejta të garantuara karshi ndërmarrjeve të tjera publike. Tjetërsimi i ndërmarrjeve publike nuk mund të bëhet pa vendim të Kuvendit. Natyrisht se Trepça duhet të ishte një ndërmarrje publike me status të veçantë dhe jo ndërmarrje publike që mundësia të tjetërrsohet pa e pytur fare organin më të lartë të përfaqësuesve të qytetarëve. Konsideroj se domosdomërisht njëri nga amandamentet duhet të ishte roli i Kuvendit dhe vendimarrja e Kuvendit të definohet qartë. Gjëja tjetër është se në mungesë të strategjisë dhe në mungesë të informatave për Kuvendin se cili do të jetë vizioni dhe strategjia afatgjatë për Trepçën atëherë kjo rrezikon se pas miratimit të ligjit vendimin madhor dhe rrënjësor për Trepçën në bazë të momentit dhe në bazë të studimit më të thellë sa i përket interesit për Trepçën dhe në anën tjetër interesit të Kosovës nga Trepça. Ne këtu duhet të flasim se cili do të jetë interesi i Kosovës që do të ndikohet nga Trepça, si ndërmarrje me ligj këto dhe me njësi biznesore të cilat themelohen apo transformohen në shoqëri aksionare minierat e këto dhe në nivel tjetër dhe me teknologji të plumbit, zinkut dhe industria kimike duhet të themi se po bëhet një ridefinim. Trepça është quajtur Kombinat tani mund ta quajmë kompleks, mirëpo e ka kuptimin e njëjtë. E cili është kompleksi e cili është kombinati, kombinati ka qenë një vijë e dizajnuar e prodhimit industrial që prej burimeve resureve minerale e deri të produktet finale që kanë marrë kohë të ndryshme në bazë të industrive që kemi pasur dhe tani me këtë ligj po ndodh edhe shthurja e këtij kombinati në disa degë dhe po lihen anash kapacitetet industriale që kanë qenë pjesë e Trepçës dhe jemi marrë vetëm me përfundimin e produkteve finale dhe jo metaleve të interreguara, por produktet finale që janë këto metale. Në anën tjetër e kemi në ligj të përcaktimi i aksionarëve që është 80% Qeveria dhe 20% i takojnë puntorëve duhet ta kemi parasysh një gjë në Republikën e Kosovës pasi që jemi Republikë Parlamentare. Qeveria nuk mund të pronësoj aksione, qeveria është adminstratore për aksione të ndërmarrjeve publike sipas ligjit për ndërmarrje publike, por këto ndërmarrje janë të pronësuar nga populli i Kosovës dhe rrjedhimisht edhe është që çështja që Kuvendi të merr vendime për tjetërsim të tyre pasi që Kuvendi llogaritet të jetë organi përfaqësues i vullnetit të qytetarëve e jo Qeveria, mendoj që kjo është shmang dhe nuk duhet të ndodh. Sa i përket punëtorve natyrisht se punëtorët duhet të kenë një pronësi mbi Trepçën siç harmonizohet në ligj, realisht mendoj se në formën siç është ky ligj kjo 20% të pronësisë të aksioneve të punëtorëve mbi Trepçën të paktën për një fazë afatshkurte apo afatmesme nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në pozicionin financiar të punëtorëve. Afati është shumë i shkurtë pasi

që për 3 vjet, pasi që ligji të hyj në fuqi si aksionar këtu është drejtori i Trepçës, ndoshta e dinë më mirë që të mos mbesin disa minatorë që janë pensionuar, pasi që ata kanë dhënë kontributin e tyre shumë më herët, pasi kjo Trepçë nuk është ndërtuar 3 vjet më parë, por është shumë më moti. Është përmendur disa herë, besoj që duhet të përmendet përseri, pasi që asetet e Trepçës dhe miniera të cilat nuk janë drejtpërsëdrejti në pronësi të Trepçës, pasi që nuk janë përmendur në ligj mendoj që duhet të përmenden pasi që janë disa në territorin e Kosovës dhe disa jashtë saj. Çështja e borxheve të pretenduara të trajtohen këtu shkurtimisht në këtë ligj, konsideroj se ka një ndryshim të një qasje që ka qenë më herët sa i përket Trepçës kur është menduar se duhet të ndahet Trepça në dy pjesë, një pjesë të jetë e lirë nga pretendimet e pjesa tjetër të jetë bartëse e pretendimeve. Pasi që në ligj nuk konfiguroni aty me gjasë ka ndonjë ndryshim të Qeverisë. Mendoj se duhet të shikohet me kujdes, pasi që një pjesë e pretendimeve janë që vijnë nga Serbia që vijnë nga vitet e 90-ta, dhe vijnë kur Trepça ka qenë në administrim të dhunëshëm. Të bëhet një ndarje e qartë se deri ku Republika e Kosovës merr përgjegjësi për borxhet e krijuara për një regjim diktator që ka qenë regjimi i Millosheviçit. Në këtë drejtim konsideroj se duhet të jemi tepër eksplisit dhe të vendosur pasi që për ndryshe lë hapësirë për manipulime të ndryshme edhe pas shëndrrimit të Trepçës në shoqëri aksionare. Neni 12 që është për mua goxha i rëndësishëm edhe pse është i trajtuar në formë të përgjithshme edhe pa kurrfar vendimi të qartë. Në vazhdim këtu p.sh. parashihet 4 mundësi që duhet t'i krijonte Trepça që duhet të jetë atraktive për investime të gjitha këto i hapin mundësi kapitalit privat në treg apo në njësi të caktuara biznesore, po askund tjetër në ligj nuk flitet për përgjegjësitë që duhet t'i kishte kapitali publik i Trepçës se këtu po flasim për mundësitë e kapitalit privat, kjo është vetëm për t'i hapur rrugë privatizimit të pjesëshëm të Trepçës. Po në ndërkohë duhej thuhej meqenëse po shëndrrohet shoqëri aksionare merr përgjegjësi për investim në Trepçë nga fondet publike ose p.sh. që Trepça, si shoqëri aksionare, t'i trajtojë mundësit tjera të financimit, përveç ato që vijnë nga sektori privat, nga kredit, nga lëshimi me letrat me vlerë, por pse të mos blejë kredi si ndërrmarje? Kjo është shumë brengosëse në formën se si është formuluar, edhe pse Qeveria thotë se nuk kemi studim fizibiliteti, rrjedhimisht nuk e dimë se çfarë do të bëjmë më Trepçën në ligj na kanë treguar se çfarë do të bëjmë më Trepçën, pavarishtë nëse e dimë ose jo.

Enver Hoti potencoi nenin 12, paragrafi 4, ku thuhet në rast se investitori privat krijon një pjesëmarrje më të madhe se 50% në njësinë biznesore, qeverisja dhe organizimi i entitetit biznesor bëhet sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Ai kërkoi të sqarohet ky paragraf.

Ministri sqaroi se sa i takon disa çështjeve që u ngriten tani, konceptualisht ne, nese deri sot kemi pasur dy ligje që njëri trajton ndërrmarjet publike dhe tjetri ndërrmarjet private shoqëritë tregtare, në këtë rast, siç përshkruhet te neni 3, te përkufizimet pika 1.3 legjislacioni relevant ligji për ndërrmarjet publike dhe ligjet për shoqërit tregtare, tani e kemi një ligj për Trepçën. Disa gjera që aty nuk janë precizuar dhe përkufizuar, ne i kemi në këtë ligj për shkak të specifikave që i ka Trepça, pasi që nuk mund ta trajtojmë si një ndërrmaje publike p.sh. hidroregjioni jugor i ujit apo si një shoqëri tregtare, një ndërrmaje private p.sh. që merret me blejren e produkteve të ndryshme. Pra, këtu ka një karakter krejt ndryshe dhe duhet të specifikohet më mirë. Pastaj nëse hyjmë në esencë çfarëdo që e shiheni sikurse këto që i përmendi deputeti Ymeri, diçka ka te ligji që mund ta shiheni, te neni 12 p.sh. paragrafët 3,4,5 të cilat tregojnë që nëse investitori privat. Pra, ka një pjesëmarrje më të madhe të kapitalit atëherë vlejnë ato që ne i kemi. Ne nuk i kemi futur këto, sepse gjithmonë i referohet legjislacionit relevant. Nëse flasim për pronsinë është e definuar në ligjin për ndërrmaje publike nenet 3 dhe

neni 9 mund ta shihni neni 9, paragrafi 1 që flet për rolin e Kuvendit. Nëse ju e shiheni të arsyshme ne mund t'i referohemi përsëri asaj. Mirëpo gjithmonë në raste të tilla dihet që baza ligjore ekziston ose te ligji për ndërmarrje publike, ose te ligji për shoqëri tregtare dhe mendoj se këtu nuk ka as hapësirë për dyshime apo për dykuptimsi. Sa i takon pjesës, siç u quajt "shthurje" ne e dijme se në Trepça kanë eksistuar 27 njësi organizative prej tyre e kemi edhe drejtorin këtu. Edhe me puntorët, edhe me ekspertët të tjerë, edhe me menagjerët të Trepçës, ne e shohim se janë vetëm 6 njësi që kanë bartur barrën kryesore të procesit të punës që është procesi themelor dhe pastaj të tjerat janë themeluar për çështje të tjera. Madje jo vetëm me këto që lidhen me prodhimin e disa produkteve të tjera, por marrim që ka pasur veprimtari të cilat nuk janë marrë fare me fushveprimtarin e Trepçës, shembull stadiumi dhe të tjerat. Në kuadër të kapitullit për përgjegjësitë sociale në raport me komunitetin kemi thënë se nga rentat minreale lejohet një përqindje të shkojë në këto investime. Për sa i takon asaj që tha deputeti Hoti paragrafit 4 në kuadër të nenit 12, nëse investitori privat krijon pjesëmarrje më të madhe se 50% në njësinë biznesore Qeverisja, organizimi shoqëror bëhet sipas legjislacionit. Më parë kjo shihet nga pjesmarrja në kapital, te pjesa e aksionareve dhe kjo përsëri definohet me ligjin për shoqëri tregtare, ashtu si edhe neni paraardhës se bordi mbikqyres i Trepça Sh. A mund të vendosë aranzhmane kontraktuale për qeverisje dhe menaxhimin e njësive përkatese, kur pjesmarrja e sektorit privat në kapital është me e vogël se 50%. Pra, në raste kur mund të ketë një investitor i cili për një shumë të caktuar kërkon një pjesëmarrje në këtë bord, atëherë mund të vendosen aranzhmane të tjera kontraktuale në njërin rast i referohemi njërit ligj në rastin tjetër ligjit tjetër. Tani ne në Trepçë themi kemi 3 dokumente referuse ligjore, ligji bazik për Trepçën, ligji për ndërmarrjet publike dhe ligji për shoqërit tregtare. Mënyrë asgjë nuk është jashtë baze për sa i takon nëse mund ta quajmë mbi tokën, ndërsa, sa i takon nëntokës ajo është e precizuar me Kushtetutë edhe me nenin 2, paragrafi 2, ligji për miniera dhe minerale dhe këtu nuk ka asnjë mëdyshje se duhet të jetë kështu. Sa i përket pjesmarrjes së sektorit privat të themi hapave konsekuent në aspektin e logjikës i cili duhet të ishte i 1,2,3, duke parë një gjë të tillë ndoshta në këto rrethana është më mirë që kemi në këtë mënyrë, para studimi i fizibilitetit, strategjia dhe ligji. Mirëpo, po të bëheshin të gjitha këto strategjia mund të na jepte një rekomandim në të bënim një ligj dhe pastaj pas 3 vitesh të ndryshonin rrethanat dhe do të duhej që përsëri t'i ktheheshim ligjit. Në këtë mënyrë me ligj kemi lënë shumë dyer të hapura i referohemi strategjisë përsëri vendimi merret në Qeveri edhe në Kuvend, sipas nenit 9 për ndërmarrje publike, paragrafi 1 dhe ne e lëmë të hapur për secilin vendim që duhej aksionarët, Qeveria dhe Kuvendi ta marrin. Sot besoj që pajtohem për ligjin edhe për vendimet strategjike në të ardhmen duhet të pajtohem. Edhe një informatë për deputetin Sasha, ne kemi edhe në formë të shkruar të gjitha ftesat që janë bërë pjestarëve të ministrisë nga AKP edhe nga qeveria 6 ftesa për 6 takime, por përfaqësuesit tuaj nuk janë përgjigjur. Në këto takime edhe pas kësaj kemi pasur disa konsultime. Mendoj që edhe ligji ashtu siç e thanë deputetët, i trajton të gjitha çështjet, e shihni edhe vetë kjo që lidhet me puntorët, ashtu si pasuritë e Kosovës që i takojnë Kosovës njëjtë edhe puntorët e Kosovës nuk i bëjmë asnjë dallim pavarësisht etnisë.

Ahmet Tmava, drejtor i Trepçës, theksoi se përpjekjet për zhvillim të Trepçës nuk janë të sotit, kanë pasur një kontinuitet. Në të gjitha këto periudha të mbijetesës ka pasur vërtet periudha shumë të vështira që të shpëtohet Trepça, sepse ka qenë një situatë shumë komplekse dikur në vitin 2010 ku është dërguar në parlament dhe është proceduar, ka pasur shumë takime, tryeza shkencore dhe nivele akademike dhe takime të shumta me juve, deputetët. Asnjërit prej juve nuk i ka munguar takimi me Trepçën, keni qenë shumë herë pjesë e këtyre diskutimeve. Kemi ardhur në një koncenzus që i kemi rekomanduar si vendim Qeverisë edhe Komisionit i

falenderohemi sepse kanë dhënë shumë punë. Pastaj Qeveria ka dhënë këtë alternativë se ne mendojmë se nuk është përfekt, por është një ligj shumë i mirë sa i përket rrethanave dhe na jep mundësi, kjo për neve na jep fuqi sepse euforia na kalon. Ne, nesër, duhet t'i përvishemi punës dhe të fillojmë prodhimin. Trepça me të vërtetë sjell shumë komplekse edhe unë po e pranoj plotësisht se duhet të precizohet rritja e shkallës së finalizimit, nuk duhet ta gëzojmë asnjëherë interesin prej fitimit të këtij resurrit deri sa të arrijmë rritjen e shkallës së finalizimit. Deri në nivel të minierave të koncentreve po mbijetojmë në këto telashe po jetojmë, mirpo në rrethanat e reja sigurisht është shperputhje e statusit dhe në atë pikën maksimale të eksploatimit dhe vurjen në levizje të resursit. Më të vërtetë për kolegët e pjesës veriore ata janë kolegë tanë dhe kemi bashkëpunim përfekt shkembejmë mjete pune gjithçka është në rregull kur nuk kyçet politika. Është me rendësi për neve shumë ky ligj, ju ftoj si përfaqësues të popullit ta votoni dhe ne pastaj të merremi me këtë përgjegjësi.

Besim Beqaj theksoi se duke filluar prej partneritetit publiko-privat sepse secili prej atyre formave rregullohet me një ligj, pastaj nëse bordi mund të bëjë aranzhmane kontraktuale, kush është baza ligjore që mund të bëjë aranzhmanin kontraktual? Ne duhet ta kemi të qartë, partneriteti strategjik të jetë i qartë në ligj, duhet të specifikohen. Ne duhet t'i bëjmë në amandamente. Ne besojmë se ligji si i tillë është shumë i mirë për hapat zhvillimor.

Visar Ymeri theksoi se jam dakord që Trepça nuk bënë të trajtohet si njëra nga ndërmarrjet publike, duhet të jetë ndërmarrje e veçantë publike. Mirëpo veçantia e shprehur në ligj është tjetër. Tani kur i referohemi nenit 9 për Trepçën, e jo për ndërmarrje publike. Zgjedhja e bordit bëhet sipas ligjit për ndërmarrje publike, çka është e veçantë për mua që po ndodh është te formulimi që duhet ta specifikojmë në mënyrë të qartë tjetërsimi i pjesshëm apo investimi privat kalimi i njëres prej njësive biznesore që bëhet me vendim të bordit a do të kaloj ajo në Kuvend? Te neni 4 thotë se Qeveria e Kosovës është pronare e 80% e aksioneve tjetër kund nuk thotë askund. Ndërmarrjet që i ka pasur Trepça, fabrikat, që i ka pasur Trepça edhe një pjesë e njësive që ka pasur Trepça nuk lidhen me punët që ka pasur Trepça, nuk mund ta krahasojmë stadiumin e Trepçës me akomulatorët, nuk janë të barabarta.

Muhamet Mustafa tha se me këto zgjidhje hapet perspektiva. Këtu u thanë disa vërejtje të cilat do t'i shohim gjatë amendamentimit. Studimi i fizibilitetit ka filluar dhe do ta kemi shumë shpejt. Projektligji është krijuar nga përvojat e suksesshme, por edhe ato të dështimeve. Ne kemi parë edhe rastet studimore. Involvimi i sektorit privat duhet të bëhet, por duke ruajtur interesin publik. Ne duhet të debatojmë për rolin e Kuvendit, bilanci i konsoliduar i Trepçës, kërkesat e kreditoreve, pjesët e Trepçës jashtë vendit dhe bordi. Mund t'i definojmë më mirë, janë disa gjëra që mund t'i rregullojmë më mirë.

Pas debatit, Komisioni me 6 (gjashtë) vota "për" dhe 1 (një) "kundër", nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligjit nr. 05/L-120 për Trepçën.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 05/L-120 për Trepçën.*
- 3. I rekomandohet Kuvendit për shmangien e Rregullores së Kuvendit, për shqyrtimin e parë të Projektligjit nr. L-120 për Trepçën.*

Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Muhamet Mustafa, kryesues, Sasha Milosvljeviq, Besim Beqaj dhe Rustem Berisha, anëtarë.

3. Shqyrtimi i raportit me rekomandime i Projektligjit nr. L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisionet e përhershme kanë shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e Komisionit. Komisioni për legjislacion ka rekomanduar të riformulohet amendamenti 8 si vijon:

“Neni 11 Zbatimi përshtatshmërisht i dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Në mungesë të dispozitave të përcaktuara me këtë Ligj, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me përjashtim të neneve 382 dhe 383.”

Besim Beqaj tha se jam njëri nga anëtarët e grupit të punës dhe kërkoj të përkrahet rekomandimi i Komisionit për legjislacion. Sepse edhe ne kemi pasur dilemën e njëjtë, që a ta hartojmë sikurse është ne amendament apo në këtë gjuhë negative siç e ka propozuar Komisioni për Legjislacion.

Komisioni e miratohet rekomandimin e Komisionit për Legjislacion lidhur me amendamentin 8.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-110 për Kamatëvonesat në transaksionet tregtare;

2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa